



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.12.2018**, me fillim në ora **10.15**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, LMT-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”,
3. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit,
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019,
5. Shqyrtimi i Platisim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 567 të datës 28.02.2017.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi – Po ju njoftoj se për këtë mbledhje kemi edhe një pikë shtesë, ajo është: Platisim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 567 të datës 28.02.2017. arsyeja e plotësim ndryshimit të kësaj rregullore është se në vitin 2017 kur është aprovuar kjo rregullore, është bërë një lëshim teknik tek taksa e Drejtorisë së Financave. E qes në aprovim pikën shtesë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika shtesë për këtë mbledhje. Tani të nderuar kuvendar e qes në aprovim rendin e ditës me pikën shtesë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

A ka dikush të shtojë diçka rreth procesverbalit, ndonjë vërejtje ose ndonjë sugjerim.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek diskutimi imë në faqe nr. 6 të procesverbalit është bërë një gabim teknik, të shtohet për shembull gjyshin tim.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu edhe tek diskutimi imë në faqe nr. 6 dhe 7 janë bërë disa gabime teknike gjatë shkrimit, është mirë që të kontrollohen edhe një herë nga procesmbajtësi dhe ato gabime të përmirësohen.

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”.

Afrim Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush e keni propozimin e kryetari të komunës që ti jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private, për hapje të

rrugës publike. Në fakte kjo rrugë është hapur para disa viteve, kjo rrugë gjendet tek rruga e UÇK-së afër biznesit Sopaj, një pjesë e kësaj rruge është pronë private dhe sipas certifikatë së pronës pronare është Hanife Hajredin Rama, sipërfaqja e përgjithshme është 25 ari 33 m². Gjatë hapjes së kësaj rrugë ka ndodhur një zgjerim, sipërfaqja që ju është mare për zgjerim është 1 ari 48 m², pala e ka paditur komunën ku ka zhvilluar procedurë, fillimisht Drejtoria për Gjeodezi, kadastrë dhe pronë ju ka përgjigjur negativisht sepse komuna nuk ka pasur mundësi financiare që të bëjë shpronësimin as këmbimin e kësaj pjesë të pronës private. Pastaj ju janë drejtuar Agjensionit kadastral të Kosovës, ku edhe atje ka mare përgjigje negative, më pastaj ka hapur procedurë gjyqësore në gjykatë, pala ka fituar kontestin gjyqësor në gjykatë dhe gjykata ka vendosur që ta rikthej lëndën tek ne për të rivendosur dhe rivlerësuar këtë parcelë. Në mbledhjen e kuvendit ne do ju bashkëngjisim në material akt gjykimin e gjykatës themelore në Prishtinë. Andaj të nderuar kuvendarë kërkojmë nga ju që të na jepni pëlqim që të i zhvillojmë procedurat për shpronësimin e kësaj pjesë.

Rasim Fazliu – Ne e mbështesim këtë propozim të kryetarit për shpronësim të kësaj prone, drejtori na i dha disa sqarime se kjo pjesë ka qenë në kontest gjyqësor më duket, po ashtu më duket se ende nuk është zgjidhur ky problem përmes gjykatës. Si duket kjo rrugë është funksionale që disa kohë, ka mbetur vetëm që ti kompensohet, prandaj mendoj se nuk kemi se çka të flasim më shumë rreth kësaj pike, kurse zonjës në fjalë nëse i takon atëherë duhet që ti kompensohet.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, ajo që dua të them unë është se ne duhet që të përkrahim këtë propozim pasi është në pyetje rruga publike sepse kjo është në interes të qytetarëve, për fillim është bërë një punë shumë e mirë dhe për herë të parë ne e kemi një skicë të këtij lloji në projektor, ne gjithmonë kemi bërë vërejtje që të kemi këso skica në mbledhje sepse ne nuk i dimë të gjitha rrugët, kurse skica do na i sqaron më në detaje. Pra ne këtu kemi të bëjmë me zgjerimin e rrugës e jo hapje të një rruge të re kjo rrugë ekziston, sa e kuptova kjo pjesë që jemi duke diskutuar veçse është pjesë e kësaj rruge por vetëm se pala është duke kërkuar që të kompensohet, mendoj se kjo rrugë është me rëndësi publike për qytetin e Rahovecit sepse kjo rrugë i lidhë edhe dy rrugë të tjera shumë të rëndësishme dhe në këtë rrugë ka qasje një lagje tërë.

Dervish Çadraku – Po ashtu edhe unë nuk kam asgjë kundër kësaj pike, e përkrahi këtë pikë që të kalojë për kuvend, por kam një pyetje sepse nuk është rasti i parë që na vinë kontestet gjyqësore të cilat kanë ndodhur për arsye të këtyre pronave për zgjerim të rrugëve etj. Pyetje ime është pse të vijmë deri tek kontesti gjyqësor, a nuk kanë pranuar ata në fillim që të lëshojnë këtë pjesë, apo komuna nuk e ka pyetur fare dhe këtë pjesë e ka bërë rrugë, mua më duket paradoks sepse komuna ka ndërtuar rrugën kurse ajo nuk është kënaqur me këtë, pastaj nëse keni biseduar a ja keni treguar çmimin për këtë pjesë. Të gjitha këto i them sepse nuk është rasti i parë që komuna është duke humbur në këso konteste gjyqësore. Kisha dashur të di se ku qëndron problemi këtu, a është problemi i neglizhencës të gjykatës ose komunës apo kjo çështje është përtej komunës.

Fahrije Lushi Morina – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, jam kureshtare në këtë drejtim sepse tek pika e katërt thuhet Pronarja e pjesë së ngastrës kadastrale e cekur në pikën dy të këtij propozimi do të kompensohet komfor dispozitave ligjore për shpronësimin e pronës të paluajtshme, do të kërkoja nga ju që të më tregonit se me çka do të kompensohet kjo zonjë, me tokë apo me mjete financiare.

Afrim Oruçi – I nderuar z. Çadraku gjatë hapjes së kësaj rruge edhe parcela nga prona të tjera private janë marrë, por kur bëhet zgjerimi i rrugës palët nuk reagojnë, ata deklarohen se kjo është për të mirën tonë dhe të komunitetit që jetojnë në atë pjesë, vetëm a jeni ju që të hapni rrugë kështu ata deklarojnë në fillim. Por kjo zonjë pas disa viteve që është hapur rruga ka hapur kontest në gjykata, këtë e ka bërë vetëm kjo e jo palë dhe e ka fituar kontestin sepse është pronë e saj. Po besoj se në të ardhmen nuk do të bëhen më kështu punët, tani për të hapur një rrugë ose për të bërë zgjerimin e një rruge ne do të kërkojmë një deklaram nga pronari që ai tek ne ta përkthej llojin e pronës private në pronë shoqërore. Kjo nuk ka qenë neglizhencë e jona por e vetmja kjo palë e ka shfrytëzuar këtë rast, pra është bërë keqpërdorim i besimit karshi neve. E nderuara znj. Fahrije Lushi, ne së pari kërkojmë nga ju një pëlqim pastaj pas kësaj vinë procedurat e tjera ligjore si pëlqim që ne të ja fillojmë me procedurat për shpronësim, ne do ti drejtohem MF në departamentin e pronës i cili pastaj do të bëjë vlerësimin, ky departament dele në vendin e ngjarjes dhe e vlerësojnë këtë pronë. Ata pastaj na dërgojnë një vendim preliminar neve dhe palës në lidhje me shumën, pala ka drejtë ankese prej 30 dite, pas kësaj nëse pala nuk reagon dhe pajtohet ne e nxjerrim një vendim preliminar dhe ekzekutohen mjetet në mënyrë të rregullt.

Dervish Çadraku – I nderuari drejtor atyre pronarëve që ju merrni ju pjesën e parcelës për zgjerim të rrugës a ja ofroni palës çmimin e pronës, pastaj a japin deklaratë ata se a e pranojnë çmimin ose që po ju falin tokën edhe pse më duket paradoks që të ja falë këtë pjesë të tokës komunës kur e ka mundësin që të kompensohet. Mendoj se është dashur që të keni deklaratën e secilit pronar që e ka liruar tokën për zgjerim të rrugës, dhe pastaj nëse ai hynë në kontest gjyqësor ju e keni mbulesën, kurse kështu si ka shkuar deri tani nuk është mirë.

Afrim Oruçi – I nderuar z. Çadraku ne fillimisht ne bëjmë vetëm propozim dhe i drejtohem me kërkesë departamentit për shpronësim, ne nuk caktojmë shumë, pastaj ky departament e vendos me vendim dhe ja dërgon palës private dhe komunës se kaq vlen kjo parcelë, pastaj pala ka afat 30 ditë që të hapë kontest në gjykatë jo me ne por me departamentin, nëse pala nuk e hapë ne e nxjerrim vendimin përfundimtar dhe i ekzekutojmë mjetet.

Rasim Fazliu – Mendoj se drejtori në një pjesë të fjalimit ishte shumë i qartë, kjo që ka ndodhur deri më tani është mirë që të na shërbej neve si mësim që herrave tjera të bëhet pronë shoqërore, të lidhet kontrata e pastaj të bëhet hapja ose zgjerim i rrugës, kështu mundet të na ndodhin shumë e shumë probleme dhe me këtë pastaj do të dëmtohet buxheti i komunës.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutim, e qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë (2) e rendit të ditës. Pika e radhës është:

3. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit.

Samir Mustafa - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duke u bazuar në nenin 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 9, nenit 40, nenit 74 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, kryetari i komunës propozon Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Rahovecit. Pakoja e shërbimeve primare të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se 190 euro për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht. Të nderuar anëtar të KPF-së ju ftoj që ta përkrahni propozimin e kryetarit.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë pranishmit, desha të di se pse nuk mundet të ketë kosto më të lartë se 190.00 €, mendoj se ky propozim duhet që të diskutohet në kuvend, pastaj kuvendi të vendos shumën se sa duhet të jetë, Bashkësisë Islame edhe më herët i kemi ndarë 200.00 € për mbulim të gjitha shpenzimeve të varrimit, por vetë ju keni kërkuar që të jetë 180.00 € sepse është duke u dëmtuar buxheti i komunës së Rahovecit, pyetje ime është: Pse ju tani dëshironi që të rritni këtë shumë në 190.00 €.

Fehmi Cena – Ky vendim komunal ka qenë edhe më parë dhe ne jemi dëshmitarë se ky vendim është i pranuar tek qytetarët, prandaj ne si kuvendarë i japim leje këtij vendimi që të vazhdoj edhe për vitin e ardhshëm. Por unë vetëm kisha kërkuar një sqarim se nga cili pozicion do të sigurohen mjetet për mbulim të këtyre shpenzimeve. Mendoj se kishte me qenë e arsyeshme që të shtohet edhe një pikë në vendim se nga cili pozicion do të jenë mjetet për mbulim të shpenzimeve të varrimit.

Samir Mustafa – Sa i përket pyetjes së kuvendares znj. Florida Bajraktari, ne kemi pasur takime me Bashkësinë Islame ku jemi mare vesh që të bëhet marrëveshja prej 190.00 € për një rast, e dimë që vitin e kaluar ka qenë 180.00 €, por kërkesa e Bashkësisë Islame ka qenë që kjo shumë të ngritët në dy pozicione nga 5.00 €, hapja dhe mbyllja e varrit ka qenë 40.00 €, kërkesa e tyre është që të jetë 45.00 €, po ashtu edhe kujdestaria ka qenë 5.00 €, kërkesa e tyre është që të bëhet 10.00 €, të gjitha këto janë bërë në marrëveshje me Bashkësinë Islame. I nderuar z. Fehmi Cena, shpenzimet e varrimit të dot paguhen nga kodi i Mallrave dhe Shërbimeve, por gjithsesi se do a përfshijmë në vendim këtë propozim tuajin.

Kryesuesi - E qes në votim propozim vendimin e Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të KPF-së ne me datë 04.12.2018, së bashku me anëtarët e KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete kemi qenë në një punëtori në Prizren të organizuar nga OSBE-ja, ku e kemi bërë edhe hartimin e Planit të Punës së Kuvendit. Kemi pasur disa sqarime dhe disa propozime rreth këtij plani nga anëtarët e KPF-së dhe Komitetit për Komunitete.

Rasim Fazliu - Ne rreth këtij Plani të punës së Kuvendit është e vërtetë kemi diskutuar ku i kemi dhënë disa ide dhe disa propozime në atë punëtori të organizuar nga OSBE-ja, ne jemi pajtuar me këtë plan të punës, por ne do të lëmë hapësirë pak më tepër që në kuvend të diskutojmë pak më gjerësisht rreth planit të punës së kuvendit për vitin 2019.

Dervish Çardaku – Po ashtu edhe unë pajtohem që ne e kemi dhënë kontributin aq sa kemi mundur në atë punëtori të organizuar nga OSBE-ja, por unë e kam një vërejtje që e kam theksuar edhe më herët rreth këtij plani tek renditja e pikave të rendit të ditës, pika e 2 e rendit të ditës Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve. Ne të gjithë anergjinë jemi duke e harxhuar në këtë pikë duke bërë pyetje dhe më duket se është duke u bërë garë se kush është duke bërë pyetje më shumë, në mënyrë që të na deponohet në procesverbal që kishe ne kemi diskutuar shumë, kurse në realitet mendoj se kjo pikë nuk ka ndonjë rol të madh, prandaj mendoj dhe propozoj që kjo pikë të mbetet për në fund të mbledhjes, në mënyrë që energjitë të i orientojmë në pikët që janë më të rëndësishme për qytetarët.

Kryesuesi – Ju falënderoj z. Dervish Çadraku, ju mundeni këtë të bëni si propozim në kuvend e pastaj nëse keni përkrahje në vota do të ju realizohet, sepse kjo duhet të hidhet në votim në kuvend.

Rasim Fazliu – Pa dashtë që të polemizoj me z. Dervish Çadraku, por të nderuar ne vetë kuvendarët jemi ata që kemi kërkuar që kjo pikë të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës, arsyet kanë qenë të shumëfishta, njëra nga ta është se në fillim të gjithë si kuvendarët po ashtu edhe drejtorët e drejtorive janë prezent, kurse nëse mbetet në fund të mbledhjes atëherë shumica e drejtorëve dhe kuvendarëve nuk po janë prezent në sallë. Mendoj se kjo pikë është mirë aty ku është, dhe unë së bashku me grupin tim të PDK-së mendoj se ashtu duhet të mbetet, por siç e tha edhe kryesuesi për atë vendosin kuvendarët sepse ajo mundet të ndryshohet vetëm me vota të kuvendarëve.

Dervish Çadraku – Nuk ishte çështja që sot menjëherë të bëhet ky zëvendësim i pikave, të kisha pas të drejtë të bëjë vetë e kisha bërë pa ju pyetur, por unë e dhashë një propozim, ne këtë e kemi provuar dhe jemi duke parë që nuk sjellë ndonjë produktivitet të madh kjo punë, prandaj propozova që ta bëjmë si pikë të fundit, sepse shpesh herë ka ndodhë që disa procese i kemi provuar por nuk kanë shkuar mirë dhe më vonë ja kemi ndryshuar qasjen. Kishte me qenë mirë që kjo të shkoj sipas procedurës si ka ardhur, në mënyrë që ta provojmë. Do të propozoj në kuvend por nuk do të thotë se duhet të tjerët të pajtohen, unë mendoj se do të jetë më mirë, do të shohim në kuvend a ka edhe ndonjëri këso mendimi.

Fehmi Cena – E cekët se me 04.12.2018 e kemi mbajtur një punëtori ku kemi diskutuar rreth Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019, mendoj se ne si këshilltar e kemi dhënë një lloj kontributi.. jam duke parë në materialin që e kemi para vete se janë bërë disa plotësime, e vlerësoj Planin e punës së Kuvendit për faktin se ky plan neve na ofron një pasqyrë më të saktë për aktivitetet për punët si të komunës ashtu edhe të kryetarit, pastaj për ne është më lehtë që ta bëjmë vlerësimin e punëve të kryera ose të pakryera. Tek muaji janar ajo që më ka rënë në sy është se në pikën e tretë të rendit të ditës ku ceket Informata e kryetarit të komunës mbi planin e punës së ekzekutivit për vitin 2018, nuk e di a është me vend kjo mos ndoshta është bërë ndonjë gabim teknik, mos duhet të jetë për vitin 2019, ose mos duhet të jetë Raporti i punës për vitin 2018. Pastaj Shqyrtimi i planit për vitin 2018 të zyrës së auditorit të brendshëm, mos duhet edhe këtu të jetë për vitin 2019. Nëse janë bërë gabime teknike le të përmirësohet për në kuvend, këto ishin disa vërejtje për këtë plan.

Kryesuesi – E qes në votim Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2019: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Platisim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 567 të datës 28.02.2017.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kur është miratuar Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me datë 28.02.2017, ne tani e kemi hasur një gabim teknik sepse në këtë rregullore nuk është paraparë ose është hequr pavetëdije një taks nga 10.00 € dhe 20.00 €. Ne e kemi kontrolluar komplet transkriptim si nga mbledhja e KPF-së, po ashtu edhe të mbledhjes kur është aprovuar kjo rregullore, aty askush nuk e ka cekë që kjo taksë largohet nga Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Ne jemi konsultuar edhe me MAPL-në, ata na kanë kërkuar që ky plotësim ndryshim të bëhet në procedurë të rregullt. Këtu kemi të bëjmë me taksën për automjete të cilët kanë deri në 3500 cm³ shuma 10.00 € dhe mbi 3500cm³, shuma 20.00 €.

Dervish Çadraku – Ajo që më intereson mua është se nëse është shmangur kjo taksë, mjetet a janë grumbulluar nga qytetarët dhe a kanë shkuar në destinacionin për të cilin është thirr ky dokumentacion. Zyrtarët komunal kur e kanë marrë që mjetet janë duke ardhur kurse dokumentacioni është i mangët pse nuk kanë reaguar më herët, pse tani pas kaq kohe.

Fehmi Cena – Sipas shpjegimit të shefit të zyrës ligjore po del që është a marr një vendim, por nuk është zbatuar në praktik, ose është zbatuar në praktik, por qëllimi kësaj pagese cili është, sa e di unë ne kur e regjistrojmë makinën e kemi një taks që duhet të paguajmë në komunë prej 10.00 € , kjo taksë kaq vazhduar që të paguhet.


Rasim Fazliu – Konsideroj se mirë është që ka ardhur ky propozim nga kryetari për plotësim ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, është mirë që do të plotësohet kjo rregullore, nëse pyesim tani pse ka ardhur deri tek kjo atëherë ne duhet që të ja bëjmë pyetje edhe vetvetes si kuvendar, por kjo ka ndodhur tanimë, por mirë që është vërejtur dhe tani do e plotësojmë në mënyrë që në të ardhmen mos të kemi këso probleme. Ne si grupe i PDK-së jemi për këtë propozim që të kalojë për kuvend.

Kryesuesi – E qes në votim Platisim ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 567 të datës 28.02.2017: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

5, Të ndryshme.

Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së fundit, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:00

Procesmbajtësi,

 Skender Hamza

